



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

KUVENDI

NR. 862 DATE 24.03.21

AKT NORMATIV

Nr. 9, datë 22.3.2021

PËR

**MIRATIMIN E TEKSTIT TË MARRËVESHJES, NDËRMJET
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE,
MINISTRIT TË SHETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË
SHËNDETIT PUBLIK DHE DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR
“KEYMEN ILAÇ SANAYI VE TICARET”, A.Ş, PËR FURNIZIMIN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME VAKSINËN E INAKTIVIZUAR
KUNDËR COVID-19 (VERO CELL) CORONAVAC, TË KRIJUAR NGA
SINOVAC LIFE SCIENCE CO, LTD. DHE TË PRODHUAR NË
REPUBLIKËN POPULLORE TË KINËS**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Neni 1

Miratimi i tekstit të marrëveshjes

1. Miratimin e tekstit të marrëveshjes, ndërmjet, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar “Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret”, A.Ş, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër Covid-19 (Vero Cell) Coronavac, të krijuar nga Sinovac Life Science Co, Ltd. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.
2. Marrëveshja për furnizimin, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe “Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret”, A.Ş për shkak të sekretit tregtar dhe kërkesës së shprehur në marrëveshje nga “Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret” nuk do të publikohet në asnjë website të institucioneve apo në “Fletoren zyrtare”.

3. Të gjitha institucionet e përfshira në dhënien e mendimit, të miratimit apo që janë pjesë e procesit kanë detyrimin të mos bëjnë publike marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ apo pjesë të saj.
4. Detyrimet e organeve shtetërore dhe përjashtimet nga detyrimet për furnizimin e vaksinës anticovid, të përcaktuara në aktin normativ nr.1, datë 10.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, janë të njëjta edhe për furnizimin e vaksinës së inaktivizuar kundër Covid-19 (Vero Cell), Coronavac të krijuar nga Sinovac Life Science Co, Ltd. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës, të furnizuar për Shqipërinë nga Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret A.Ş, sipas kushteve të tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij akti normativ.

Neni 2 **Efektet financiare**

Efektet financiare, që rrjedhin nga marrëveshja bashkëlidhur këtij akti normativ, përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2021.

Neni 3 **Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

OGERTA MANASTIRLIU

**MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 1540/1
DATË 23.3 2021

KUVENDIT
MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjell Agaci', is written over a circular blue official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' at the top and 'KESHILLI I MINISTRAT' at the bottom, with a central emblem.